



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 16/18
Prishtinë, më 07.02.2018, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Blerim Kuçi, Mërgim Lushtaku, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Gani Jashari - anëtar dhe kryesues i takimeve të bordit të drejtorëve në KOSTT, Afrim Prekazi - Anëtar i Bordit të Drejtorëve në KOSTT, Nebih Zariqi - Anëtar i Bordit të Drejtorëve në KOSTT, Kadri Kadriu - u.d. Kryeshef Ekzekutiv në KOSTT, Nebih Haziri - Zyrtar Kryesor i Financave në KOSTT.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Mavraj - Gazetare nga Epoka e Re, Albulena Avdiu - Gazetare nga Ekonomia Sot, Adelina Ahmeti - Gazetare nga Kallxo.com.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Nita Latifi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Kryetari i Komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: Kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 24.01.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të KOSTT SH.A. për vitin 2016;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rural;**

7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajturë e Komisionit, dt. 24.01.2018

Kryetari - konstatoi se komisioni unanimisht miratoi procesverbalin e mbledhjes të dt. 24.01.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar i KOSTT (Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut) të Kosovës për vitin 2016

Gani Jashari – Raporti vjetor për vitin 2016 është definuar duke u bazuar në dispozitat e ligjit. Ky raport është punuar sipas formës së aprovuar nga njësia për politikën e ndërmarrjeve publike. Viti i kaluar ka qenë një vit mjaftë sfidues për KOSTT-in për shkak të implementimit të projekteve kapitale. KOSTT-i ende nuk ka aritur që të fillojë implementimin e marrëveshjes që të kyqet në MS , si rezultat i këtyre pengesave linja 400 kv Kosovë/Shqipëri. KOSTT ka vazhduar me pregaditje e kornizës ligjore për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, ka marrë pjesë aktive në iniciativat e ndryshme të liberalizimit të tregut dhe ndërtimin e mekanizmave të tjerë.

Kryetari – sa për informim ne kemi pasur një takim me përfaqësuesit e KOSTT-it, ku kemi diskutuar lidhur me formën e raportimit financiar të KOSTT-it në Kuvend. Sipas ligjit ekzistues, KOSTT-i është ndërmarrje publike dhe Kuvendi, përveç caktimit të pagave të anëtarëve të bordit dhe raportimit që bëhet në Kuvend, nuk ka kompetenca tjera. Sa i përket raportit financiar unë i kam disa pyetje për juve anëtarëve të bordit sepse unë i mora disa dokumente apo vendime që keni marrë, lidhur me pagat dhe kompensimet tuaja. Unë po e shoh këtu që me datën 1 dhjetor 2016, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar vendimin për caktimin e pagave për anëtarët e bordit, dhe më pas është një vendim i bordit që rritjen e pagave e kthen në menyrë retroaktive prej gushtit të vitit 2016. A mundeni që të na shpjegoni këtë punë sepse unë nuk po mundet që ta shoh që ka arsyetim ligjor për këtë vendim që keni marrë si bord?

Gani Jashari – theksoi se vendimi është implementuar ashtu siç është.

Kryetari – ky është një problem sepse ju nuk keni pasur bazë ligjore për vendimin e Kuvendit të muajit dhjetor ta aplikoni në menyrë retroaktive që nga muaji gusht. Unë nuk e di qysh ju e adresoni këtë çështje dhe unë nuk mundem juve me ju përkrahë për diçka që është pa bazë ligjore. Po ashtu unë e pashë që në një vendim tjetër ju i keni caktuar vetes kompensim nga 90 euro për mbledhje të bordit, dhe ju keni filluar që ti mbani nga 5 apo 6 mbledhje në muaj, që është edhe kundër rregullave të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve sepse bordi nuk ka nevojë për me u mbledh nga 4 apo 5 herë brenda muajit. Përveç kësaj ju keni marrë kompensime, përkundër asaj që merrni rrogën fikse siç përcaktohet me ligj. A mundeni ju të na konfirmoni a është e vërtetë kjo, sepse unë i kam vendimet, mirëpo vetëm kërkohet qëndrimi juaj, për çështje protokollare.

Afrim Prekazi – unë skam çka me dhënë koment tash sepse ato janë të shënime dhe ju i keni të gjitha informatat. Por nuk qëndron ajo që bordi i drejtorëve mbanë nga 5 apo 6 mbledhje në muaj.

Kryetari – theksoi se në bazë të shënimeve që kam, në muajin dhjetor keni mbajtur tri mbledhje, me 12, 16 dhe 26 dhjetor 2017. Në qoftë se ky komision e ka drejtën e caktimit të kompenzimeve, atëherë unë propozoj ne duhet që ti ndërprejmë mënjërerë, sepse nuk ka arsye me marrë një rrogë të nivelit të naltë për një punë që nuk është me orar të plotë dhe plus me marr shtesa për mbledhje.

Afrim Prekazi – ligji thotë që së paku 6 herë duhet që të mbahen mbledhjet dhe unë si kryetar i komisionit të auditimit kam qenë së paku 160 herë për një vit në punë. E dyta, ligji thotë se i fillon përgjegjësia anëtarëve të bordit për pjesëmarrje në takim, kjo ka ndodhë në kohën kur kemi pas pagën 650 euro. Me qenë se ne i kemi lajmëru se nuk janë këto paga dytësore sepse ne kemi edhe biznese tona duke llogaritur tatimin në të ardhura prej 19.7 përqind, ne i kemi marrë rreth 480 euro. Unë nuk besoj që ka ndodhë që kemi mbajtur më shumë se tri mbledhje ndonjëherë.

Kryetari – ju e keni një pagë që paguheni për punën që ju e bëni në KOSTT që është 1350 euro, që është një pagë e barabarët me pagën që ne paguhemi si deputetë. Për mendimin tim është një vepër joligjore që ju keni vendosur që pagat ti merrni mënyrë retroaktive nga ajo që ka vendosur Kuvendi. Keni gabuar dhe nuk di se si do të përgjigjeni për këtë veprim dhe ne nuk e kemi atë kompetencë që me bë diçka më shumë në atë drejtim.

Naser Osmani – theksoi se ne nuk jemi vetëm komision që shqyrton raportet financiare, por duhet të merremi edhe me buxhetin sepse këto janë dy çështje të ndërlidhura. Prandaj, unë e konsideroj të domosdoshme që ju kryetar të caktoni një takim me komisionin funksional dhe të diskutohet se çfarë të bëhet me ndryshimin e ligjit. Ju keni marrë një vendim të paligjshëm për zbatimin e pagave nga gushti 2016. Pra kemi të bëjmë me marrjen e mjeteve në mënyrë të paligjshme, nuk ka vendim mbi vendimin e Kuvendit. Çështja e shtesave është një çështje që diskutohet sepse këta mundën me shku edhe 365 herë në mbledhje, mirëpo ligji definon se ju takoheni një herë në muaj dhe merrni vendime në bazë të së cilave menaxhmenti vepron. Mirëpo, si mundem unë me aprovu një vendim të paligjshëm dhe ky është problemi kryesor.

Ali Lajçi – pyeti se me çfarë baze ligjore i keni rritur pagën e juaj dhe mbi çfarë baze keni marrë shtesa?

Gani Jashari - ne nuk e kemi rritur pagën. Pagën na ka caktuar Kuvendi.

Enver Hoti – e kam shtruar një pyetje në mbledhjen e kaluar për anëtarët e bordit, se a keni marrë pjesë në bisedime në dialogun për energji? Nëse po, pse nuk po realizohet linja e energjisë Kosovë-Shqipëri? Sa i përket atyre vendimeve që i kemi marrë për pagën tuaj ne nuk duhet të bëjmë kompromise as konsensus, po të shikojmë se a është bërë shkelje e ligjit apo jo, dhe nëse është bërë këta janë të përgjegjshëm. Këtë gjë e kanë bërë thjeshtë për shkak të interesave të veta.

Kryetari – nuk e vura në diskutim çështjen e reaktivitetit të pagave që është jo ligjore, dhe këtë ne nuk kemi se çfarë të diskutojmë. Diskutimi është tema e shtesave dhe këtu i kemi dy mundësi: ose neme marrë një vendim që me ja u ndërpre prej ditës së sotme shtesat, ose ju si anëtarët e bordit, me marrë një vendim për me i ndalë shtesat. Sa e kuptova unë këta u pajtuan që shtesat të ndërprehen prej sotit dhe për punën që e bëjnë paguhen vetëm me pagë, dhe për këtë kërkojmë që bordi të na sjell mes shkrim vendimin që dëshmon se i kanë ndalur shtesat.

Blerim Kuqi – çështja që na duhet me u bazue është raporti i auditimit, dhe raporti i auditorit duhet me na sqaruar çështjen e pagave se sa janë të bazuar në aktet ligjore apo nënligjore. Ne duhet me shiku raportin e auditorit dhe duhet ta dimë se auditori a e ka rekomandimin për çështjen e mëditjeve. Mirëpo, prej praktikave ekzistuese të ndërmarrjeve publike, nuk është i vetmi bordi i KOSTT-i që merrë mëditje për mbledhje dhe ne duhet me shiku edhe se si funksionojnë edhe bordet tjera. Për çështjen e pagave ne

mundemi me bë gjithëçka që është në kompetencën tonë, mirëpo puna jonë duhet me u bazu edhe në raportin e auditimit. Në qoftë se një auditor i jashtëm nuk e ka vërejtur këtë element si antiligjor, atëherë nuk është në rregull edhe me auditorin. Në qoftë se askush nuk e mbulon këtë sferë të auditimit atëherë kemi vakum të pjesës së auditimit, dhe ne duhet për me shqyrtu pjesën e kontrollit të sistemit të auditimit.

Kryetari – zotëri Kuçi ne e kemi për obligim si komision me u marrë me pagesat e bordit sepse kjo është kompetenca jonë, dhe po pajtohemi plotësisht se secili bord që vjen këtu do t'ia bëjmë të njëjtën gjë dhe shtesat do ti ndërprejmë. Kjo është një shprehje e kontributit të komisionit për ti shkurtuar shpenzimet e shtesave përtej pagave të cilat janë të paarsyshme.

Gani Jashari – zotëri kryetar unë po e shoh që edhe kahja e mbledhjes po e merret ndryshe. Ne jemi për herë të parë këtu si institucion, dhe e dyta tre anëtar janë shkarku dhe jemi pa kryetar të bordit, ju këtë duhet ta keni parasysh këtë. Mua më pëlqejë studimi i Hotit dhe i Kuçit kur i përmendi gjanat të cilat janë më substanciale, e jo mëditjet e ndryshme të cilat bëhen sepse të gjitha bordet i kanë mëditjet. Kuvendi i Kosovës ka qenë dashtë të mirret me këto çështje.

Kryetari – zotëri Jashari ju lutem se çfarë diskuton Kuvendi se çfarë diskutojnë deputetet, nuk është punë për ju. Ju këtu vetëm mundeni me ardhë dhe me raportu dhe jenit të obliguar të përgjigjeni në pyetjet që i bëjnë ky komision. Në bazë të ligjit, ne nuk po mundemi të merremi me të hyrat dhe të vetmën gjë që ne mund ta bëjmë tash janë pagesat e bordit dhe kjo është kompetencë buron nga ligji dhe ne do ta ushtrojmë.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se sa i përket pagave të bordit vendimi në Kuvend është marrë me datën 07.12.2016 dhe prej kësaj date është dashtë që të llogariten dhe paguhen pagat e bordit, dhe jo në formë retroaktive. Pagat për anëtarët e bordit janë mjaftë të larta, për një bord i cili nuk është i përhershëm, por bord joekzekutiv, dhe kjo është vendos në mënyrë që ju mos me pas shtesa dhe kompensime të tjera. Të gjitha ndërmarrjet publike deklarojnë se kanë problem në mënyrën e funksionimit, kurse në fakt me marrë beneficione për vete nuk pritojnë fare. Çdo herë kur ndërmarrja publike ka dalë me pak fitim, bordi i ka marrë dhe i ka shpërnda për vete, ndoshta ju nuk e keni bërë, mirëpo të tjerët e kanë bërë. Vendimi që ka marrë bordi për zbatimin e pagave në formë retroaktive është vendim i paligjshëm. Pagat i merrni për takimet që mbani si bord dhe ju mund të mblidheni sa herë që është nevoja, por ju paguheni për gjashtë mbledhje brenda vitit. Unë mendojë që ne si komision nuk mundemi me zgjedh këtë çështje dhe ndoshta edhe me mirë që ta zgjedhë gjykata në të ardhmen, se për çfarë arsye është marrë një vendim i paligjshëm, dhe në qoftë se e vërteton si të tillë, ata duhet me i kthy mjetet ndërmarrjes të cilat i kanë marrë në mënyrë të paligjshme. Po ashtu në mënyrë automatike të ndërprehet pagesa e shtesave të cilat në njëfarë mënyre janë të paligjshme. Unë jam shumë e interesuar që ta kemi një raport të detalizuar për gjithëçka që ka ndodhur në këtë institucion, sepse është institucion shumë i rëndësishëm.

Mërgim Lushtaku – unë e kam theksuar edhe në mbledhjen e kaluar që raporti vjetor i KOSTT-it i vitit 2016, ka të bëjë më shumë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, e jo me Kuvendin e Kosovës. Kjo ndërmarrje ka ardhur për herë të parë në Kuvend dhe me ligjin e ri i përgjigjet Kuvendit dhe llogaridhënien duhet ta bëjë në Kuvend, dhe ne sigurisht që jemi të interesuar edhe në aspektin kronologjik edhe në vitet e kaluar, por raportimi për vitin 2016 duhet të bëhet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, deri në atë kohë sa ka qenë në kompetencë për llogaridhënie në këtë ministri. Ndërsa sa i përket anës tjetër të pagave që deri me tani i përmendi kryetari, sigurisht që jemi të shqetësuar dhe asesi nuk mundemi me u pajtu, por këtë çështje besojë që është më së miri ta bëjë auditori i përgjithshëm dhe të vlerësohet se a kan pasur të drejtë apo jo, edhe pse logjika juridike tregon se nuk kan pasur të drejtë. Sa i përket shtesave kjo çështje është e vitit 2017, ne jemi duke biseduar për raportin 2016 dhe për këtë

çështje po dalim jashtë rendit të ditës. Kështu është ligji i ndërmarrjeve publike, ligji i shoqëritë tregtare dhe e kodi i etikës, që janë tri akte në të cilat ndërmarrjet publike bazohen në veprimtarinë e tyre. Sa i përket raportit unë prapë jam i asaj ideje që ky raport i vitit 2016, duhet të kalojë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe në qoftë se kanë raportuar në ministri, atëherë raporti në këtë komision është vetëm sa për me kaluar si procedurë.

Kryetari – sa për qartësim, ne jemi ngarkuar prej Kryesisë me trajtë këtë raport dhe e kemi obligim me trajtë dhe me nxjerrë rekomandimin për seancë. Çështje të cilat i ngriti zotëri Hoti nuk janë kompetencë e këtij komisioni dhe në këtë rast ne e kemi fokusin shumë të ngushtë, çështjet financiare.

Enver Hoti – ne jemi deputet dhe askund nuk shkruan që me pikë apo presje se ku e kemi ne limituar diskutimit. Çdo raport që vjenë këtu ka mu lexu pikë për pikë dhe kam të drejtë për diskutim.

Kryetari – duhet me lexu rendin e ditës në të cilën është shqyrtimi i raporti vjetor financiar, ne mundemi me diskutu edhe çështje të tjera, mirëpo unë po e tregoj se çfarë është sot në rendin e ditës.

Afrim Prekazi – mund t'iu themi se KOSTT-i është ndërmarrja më e suksesshme në Kosovë dhe më stabile deri tash, si në aspektin funksional, po ashtu edhe në aspektin financiar. Ky bord i ka shpenzimet ma të vogla se të gjitha bordet tjera dhe ndërmarrjeve tjera. Sa i përket mbledhjeve ne kemi mbajtur më së shumti deri tri mbledhje dhe ato i kemi mbajtur në dhjetor me kërkesën e ekzekutivit.

Safete Hadergjonaj – tek shpenzimet operative, shpenzimet mjekësore në vitin 2015 paskan qenë 193,000 euro, dhe në vitin 2016 paskan qenë 50,000 euro, a ka mundësi me na sqarue pak më tepër rreth këtyre shpenzimeve shëndetësore?

Nebih Zariqi – theskoi se ne kemi kontratë me një kompani private të sigurimeve për sigurimin shëndetësore dhe konformë çmimores janë bërë pagesat. Tek çështja e fitimit vjetor, KOSTTI nuk ka bërë shpërndarje të fitimit dhe është akumuluar fitimi në kapital të ndërmarrjes, dhe si informatë maksimumi i mbledhjeve të bordit ka qenë tri mbledhje në muaj, ndërsa zakonisht kanë qenë dy ose një mbledhje në muaj.

Kryetari – unë propozojë që me e dërgu raportin në seancë pa rekomandim, pra vetëm për shqyrtim. Ne nuk kemi vërejtje tek raporti, por për shkak të zbatimit të vendimit në formë retroaktive ne nuk mundemi të japim një pëlqim pozitivë sepse potencialisht kjo është shkelje ligjore.

Naser Osmani – unë nuk e përkra rekomandimin për miratimin e këtij raporti në seancë. Unë mund të ngris dorën në rast se procedohet pa rekomandim të komisionit. Por, njëkohësisht kërkojë ng që në rekomandim të futet edhe inicimi i ndryshimit dhe plotësimit të ligji, sepse ne kemi me u kthyer përsëri në situatën e njëjtë.

Kryetari – propozimi është që komisioni të rekomandojë shqyrtimin e raportit vjetor financiar të KOSTT-it për vitin 2016. Pika e dytë që të rekomandohet që Komisioni funksional për zhvillim ekonomik dhe komisioni ynë të formojnë një grup punues të përbashkët për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Si dhe një pikë të tretë, që ti rekomandojmë Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria të procedojë kandidatët për plotësimin e kryesuesit dhe dy anëtarëve të Bordit. Po ashtu kërkojmë nga bordi i KOSTT-it, që vendimin për ndaljen e shtesave me shkrim tëia dërgoni sa më shpejtë komisionit.

Enver Hoti – mendojë pajtohem që raporti me shkue në Kuvend pa rekomandime të komisionit, mirëpo jo vetëm për shqyrtim por edhe për miratim dhe ta vendos Kuvendi. Në qoftë se ne në Kuvend shkojmë vetëm si shqyrtim, atëherë mundet me u ba ndonjë debat dhe mandej ne nuk kemi kurfarë mirëkuptimi.

Blerim Kuqi – unë po ashtu propozojë që të rekomandojmë që të bëhet edhe një auditim që të na sqarojë çështjet që ngritem për pagat.

Naser Osmani – çështja e auditimit është e rregullume me ligj që kjo ndërmarrje bënë auditim të jashtëm dhe nuk mund të auditojen nga auditori gjeneral.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Për, një Kundër dhe asnjë Astenim, nxori këto

Rekomandime

1. Të shqyrtohe Raporti vjetor financiar i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT SH.A. për vitin 2016;
2. Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, të krijojnë një Grup të përbashkët Punues, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Energjinë Elektrike;
3. Qeveria të procedojë në Kuvend kandidatët për plotësimin e pozitës së kryesuesit dhe dy anëtarve të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT SH.A.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së**

Kryetari – sqaroi se ky ligj parashihet të hyjë në fuqi një vit pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare, që do të thotë se nuk ka obligime buxhetore në buxhetin e vitit 2018. Kostoja buxhetore shtesë që është vlerësuar nga Ministria e Financave, mund të akomodohet në fazat e ardhshme buxhetore. Po ashtu, amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Propozojë që rekomandimi ynë të jetë se Projektligji përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për Projektligjin nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së**

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, dhe amendamentet e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rural

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rural , nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale

Naser Osmani – raportoi se grupi punues ka shqyrtuar projektligjin, në takim kanë marrë pjesë përfaqësuesi ligjor i Ministrisë së Financave dhe zyrtarja përkatëse e Doganave. Ne kemi bërë disa ndryshime mirëpo jo shumë substanciale, dhe përmirësime me tepër në anën formale-teknike dhe gjuhësore. Projektligji sipas vlerësimit të ministrisë së financave, është rreth 95 përqind në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe dispozitat e Traktatit të Lisbonës, që e rregullon këtë çështje. Prandaj, grupi punues rekomandon që të miratohen amendamentet e propozuara, me një ndryshim teknik në amendamentin 5, ku përmendet referenca 2.2, të bëhet 2.3.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Miratohen amendamentet e propozuara nga Grupi Punues për Projektligjin nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, me një ndryshim në amendamentin 5, ku përmendet referenca 2.2, t bëhet 2.3.
2. Raporti me amendamentet procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përherhme.

8. Të ndryshme

8.1. **Kryetari** – njoftoi se Parlamenti Evropian do të organizojë një konferencën ndër-parlamentare në Shkup me datë 26.02.2018, me temë “Fuqinë e kuletës” (parasë): Fuqitë buxhetore dhe procedurat e PE-së”, dhe janë të ftuar edhe dy anëtarë të komisionit. Propozojë që Safete Hadërgjonaj dhe Dardan Molliqaj, të marrin pjesë në këtë Konferencë.

Komisioni caktojë deputetë: Safete Hadërgjonaj dhe Dardan Molliqaj për pjesëmarrje në Konferencën ndër-parlamentare, me temë “Fuqinë e kuletës” (parasë): Fuqitë buxhetore dhe procedurat e PE-së”, që do të mbahet në Shkup me datë 26.02.2018.

8.2. **Kryetari** – Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit është miratuar në lexim të parë në Kuvend, propozojë që të caktojmë një grup punues për shqyrtimin e tij. Propozojë që Unë, Mërgim Lushtaku dhe Blerim Kuçi të përbëjmë grupin punues.

Komisioni caktoi grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080, me këtë përbërje: Lumir Abdixhiku (kryesues), Mërgim Lushtaku dhe Blerim Kuçi. Grupi punues paraqet Raportin me rekomandime në Komision.

8.3. **Kryetari** – propozojë që të formojmë një grup punues për analizimin dhe nivelimzimin e pagave të stafit menaxherial të Fondit Pensional. Propozojë që anëtar të grupit punues të jenë: Naser Osmani (kryesues), Jelena Bontiq dhe Fikrim Damka.

Komisioni caktoi grupin punues për për analizimin dhe nivelimzimin e pagave të stafit menaxherial të Fondit Pensional, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Jelena Bontiq dhe Fikrim Damka. Grupi punues paraqet Raportin me rekomandime në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

**Kryetari komisionit,
Lumir Abdixhiku**
